



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM Nr. 82 datë 25.11.2011

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE  
TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SH.A “UJËSJELLËS  
KANALIZIME“ KORÇË

Këshilli Bashkiak Korçë, në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Nenit 135 pika 2, gërma d, si dhe të Statutit të Sh.A UKKO, nenit 10 pika 2, gërma d dhe nenit 21,

**VENDOSI**

1. Shpërblimi mujor i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Sh.A UKKO, të jetë si më poshtë vijon:

- Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës: 48.000 (dyzetetetëmijë) lekë;
- Anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës: 35.000 (tridhjetëepesëmijë) lekë.

2. Shpërblimi t'u paguhet anëtarëve nga data e emërimit të tyre me Vendimin e Këshillit Bashkiak Korçë Nr. 42, datë 28.07.2011.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sh.A UKKO.

Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

  
ILIR PENDAVINI